



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

DRAFT

LIGJI MBI INFERMIERINË

Neni 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij ligji është që të rregulloj dhe përcaktoj Profilet Infermiore, Kushtet për ushtrimin e profesionit, Standardet dhe nivelet e arsimit, Detyrat dhe Përgjegjësitë sipas profileve, Kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen, Kompetencat Infermiore, Etiken Infermiore, dhe çështjet tjera me rëndësi për ushtrimin e funksionit infermior.

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji zbatohen në mënyrë të përshtatshme për këto profile Infermiore:

- Asistent/e – Ndihmës infermier/e;
- Teknik/e i/e infermierisë, Mami;
- Bachelor infermieri/Mami;
- Infermier/e i/e diplomuar / Master Profesional;
- Specialist të infermierisë.

Në mënyrë analoge dhe të barasvlershëm, dispozitat e ligjit do të zbatohen edhe për profile tjera të ngjashme të përgjegjësisë dhe kompetencave të Odës.

Neni 3

PËRGJEGJËSITË INFERMIERORE

Përgatitja teorike dhe praktike mundëson infermierin/en të ketë kapacitetin dhe autoritetin për të praktikuar kujdesin infermior gjithëpërfshirës.

Përgjegjësitë Infermierore përfshijnë të gjitha aktivitetet, njohuritë dhe aftësitë e kujdesit shëndetësorë duke u bazuar në protokollet e shërbimeve shëndetësore infermierore në bazë të niveleve dhe profileve nga neni paraprak.

Infermieri/ja ka për detyrë të aplikoj dhe zbatoj standardet më të larta profesionale duke respektuar kodin e etikës, të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit, misionin dhe betimin e Infermierit, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të pacientit dhe popullatës.

Në ushtrimin e profesionit infermieri/ja ka për detyrë të respektoj të drejtat themelore të njeriut në veçanti dinjitetin, integritetin dhe privatësinë e pacientit.

Infermieri/ja ka të drejtë të refuzoj kërkesat të cilat ndeshen me të drejtat dhe lirit themelore të pacientit, kodin e etikës dhe betimin e Infermierit.

Neni 4

Infermieri/ja i kryen aktivitetet e veta në pajtim me Nenin 3 si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke u mbështetur gjithnjë në kompetencat e profileve infermierore dhe duke respektuar parimet bazike të kodit të etikës, legjislacionin në fuqi, udhërrëfyes dhe protokollet infermierore dhe klinike.

Neni 5

Kujdesi shëndetësorë infermieror është aktivitet publik dhe i nënshtrohet kontrollit të cilësisë në përmbushjen e standardeve profesionale, arsimore dhe etike.

Në ushtrimin e shërbimeve infermierore, infermieri/ja ka përgjegjësi respektimin e të drejtave themelore dhe kushtetuese të njeriut, respektimin e të drejtave dhe përgjegjësi të pacientit e në veçanti të drejtën për jetë, dinjitet dhe integritet si dhe të drejtën e ruajtjes së privatësisë.

Infermieri/ja në ushtrimin e profesionit duhet të respektoj parimin e barazisë dhe jo diskriminimit i cili bazohet në divergjencat racore, gjinore, bindjeve politike, besimeve fetare.

Qëllimi kryesor i shërbimeve infermierore është parandalimi i sëmundjeve, ndihma ndaj të sëmurëve, promovimi, edukimi shëndetësorë, dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për zbatimin cilësor të kujdesit shëndetësor infermieror.

Kujdesi shëndetësor infermieror zbatohet duke u bazuar në njohuritë shkencore dhe profesionale të arritura në arsimimin e rregullt dhe në procesin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

Infermieri/ja ka për obligim të bashkëpunojnë në mes veti, të kultivojnë raporte të mira ndërkolegiale dhe të bartin njohuritë te njëri tjetri, si dhe në përmbushjen e detyrimeve etike të bashkëpunimit ndërkolegial.

Shërbimet infermierore mund të kryhen vetëm nga infermierët, brenda fushës dhe kompetencave të tyre të fituara.

Neni 6 KOMPETENCAT INFERMIERORE

Kompetencat infermierore përfshijnë: njohuritë, shkathtësitë, procedurat e planifikimit, organizimit, kryerjes dhe vlerësimit të cilësisë së kujdesit infermieror në përputhje me nivelet e arsimit.

Kompetencat e përgjithshme

- Aplikon njohuri dhe shkathtësi në fushën e kujdesit shëndetësor, lëndët themelore të profesionit dhe grupit shoqëror të lëndëve për të kuptuar funksionet fiziologjike dhe sjelljet e individëve të shëndetshëm dhe të sëmurë, si dhe marrëdhëniet midis gjendjes shëndetësore të individit dhe mjedisit të tij fizik dhe social;
- Zbaton parimet e etikës së infermierisë - Kodi i Etikës së Infermierëve;
- Respekton Deklaratat universale për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Pacientëve;
- Siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit të shkruar dhe gojor të marrë nëpërmjet kryerjes së detyrave profesionale;
- Zbatimi i rregulloreve të vlefshme në kryerjen e detyrave profesionale;
- Merr pjesë në planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e kujdesit bazë shëndetësor / kujdesin infermieror në përputhje me procedurat e standardizuara dhe vetëvlerësimin e punës;
- Merr pjesë në planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin dhe / ose në kryerjen e ndërhyrjeve mjekësore-teknike të personave të shëndoshë dhe të sëmurë të të gjitha moshave;
- Inkurajon dhe / ose ndihmon pacientin në përmbushjen e aktiviteteve themelore të jetës duke respektuar dinjitetin e tij njerëzor dhe diversitetin kulturor;
- Merr pjesë në përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor / kujdesin shëndetësor/kujdesi infermierë;
- Mban dokumentacionin shëndetësor dhe dokumentacionin e kujdesit shëndetësor / infermier, raporton anëtarët e ekipit shëndetësor duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave;
- Përdor teknologjinë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit në formë të shkruar, të folur dhe elektronike,
- Dallon individin që i rrezikohet jeta dhe aplikon procedurat urgjente mjekësore në përputhje me kompetencat;
- Merr pjesë në kujdesin shëndetësor të një individi, familjeje dhe komuniteti të të gjitha moshave me qëllim promovimin e shëndetit dhe mënyrave të jetesës së shëndetshme;
- Zbaton procedurat për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit të shëndetshëm dhe për mbrojtjen e sigurisë personale, sigurinë e individit dhe të komunitetit;
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes në punë dhe punën në mënyrë të sigurt;
- Aplikon aftësitë e komunikimit me anëtarët e ekipit për kujdesin shëndetësor / kujdesin infermierë dhe stafin tjetër dhe me pacientin, familjen dhe komunitetin e tij;
- Zhvillon pavarësinë dhe vetë-iniciativën në punë brenda përgjegjësisë profesionale,

- merr pjesë në punën e një ekipi shëndetësor dhe / ose multidisiplinar brenda përgjegjësisë profesionale;
- Zhvillimi i përgjegjësisë për të mësuarit gjatë gjithë jetës, zhvillimi profesional dhe përmirësimi i kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Merr pjesë në edukimin e studentëve dhe në trajnimin profesional të personelit shëndetësor.

6.1 Asistent/Ndihmës Infermier

- Ndihmësi/ja i/e infermierit/es do të punojë nën drejtimin e personelit infermierik dhe do të ndihmojë në ofrimin e kujdesit elementarë për pacientët;
- Kryen të gjitha detyrat e deleguara nga personeli infermieror dhe të raportojë pas përmbushjes së detyrave;
- Nën drejtimin e infermieres/it ndihmon pacientët në mbajtjen e higjienës personale, përkujdesje dhe mbështetje gjatë të ushqyerit dhe aktiviteteve tjera ditore për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e pacientit;
- Bën bartjen e pacientit të palëvizshëm, dhe ata të cilët kanë nevojë për mbështetje për transferim dhe ekzaminime të ndryshme;
- Mirëmbanë pajisjet në mënyrë të duhur, duke evidentuar dhe raportuar çdo problem eventual tek infermieri/ja përgjegjës/e;
- Të ruaj konfidencialitet të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo/ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale.

6.2 Infermier me shkollim të mesëm

- Punon si pjesëtar/e i/e ekipit shëndetësor, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët;
- Zbaton dhe dokumenton kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politiken e aprovuar;
- Zbaton protokollet e praktikave infermierore;
- Kujdeset për higjienën personale të pacientit, ushqyeshmërinë dhe mirëqenien e tij;
- Përgatit pacientët për intervenime dhe ekzaminime;
- Përdorë dhe mirëmbanë në mënyrë të duhur dhe të sigurtë të gjitha pajisjet;
- Mundë të kryej edhe detyra të tjera të deleguara nga infermieri me Bsc.

6.3 Mami me shkollim të mesëm

- Punon si pjesëtar/e i/e ekipit shëndetësor, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët;
- Zbaton dhe dokumenton kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politiken e aprovuar;
- Kujdeset për higjienën personale të pacientit, ushqyeshmërinë dhe mirëqenien e tij;
- Përgatit pacientët për intervenime dhe ekzaminime;
- Zbaton protokollet e praktikave infermierore;
- Kujdesi gjatës shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes;

- Kujdesi për të porsalindurit dhe të ushqyerit me gji;
- Mundë të kryej edhe detyra të tjera të deleguara nga Infermier/ja-Mamia me Bsc.

6.4 Bachelor i infermierisë

- Punon si pjesëtar/e i/e ekipit shëndetësor, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët;
- Planifikon, organizon, zhvillon dhe vlerëson cilësinë e kujdesit shëndetësor/infermier;
- Merr pjesë në identifikimin e nevojave shëndetësore të personit dhe komunitetit;
- Udhëheq dhe menaxhon në përputhje me politikat institucionale shëndetësore;
- Administron terapinë e përshkruar nga mjeku;
- Përkrah dhe vepron në hartimin e udhëzuesve dhe protokolleve;
- Përcakton nevojat e pacientit për kujdesin shëndetësor;
- Mbikëqyr punën e të gjithë punonjësve që në çfarëdo mënyrë ndikojnë në procesin e kujdesit shëndetësor / kujdesin shëndetësor;
- Dokumenton ndërhyrjet dhe ecurinë drejtë rezultateve të pritura;
- Zbaton të rejat shkencore në praktik e mbështetura në evidencë;
- Merr pjesë në edukimin e studentëve dhe në trajnimin profesional të personelit infermieror.

6.5 Bachelor /Mami

- Punon si pjesëtar/e i/e ekipit shëndetësor, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurtë për pacientët;
- Planifikon, organizon, zhvillon dhe vlerëson cilësinë e kujdesit shëndetësor/infermier;
- Merr pjesë në identifikimin e nevojave shëndetësore të personit dhe komunitetit;
- Udhëheq dhe menaxhon në përputhje me politikat institucionale shëndetësore;
- Administron terapinë e përshkruar nga mjeku;
- Përkrah dhe vepron në hartimin e udhëzuesve dhe protokolleve;
- Përcakton nevojat e pacientit për kujdesin shëndetësor;
- Mbikëqyr punën e të gjithë punonjësve që në çfarëdo mënyrë ndikojnë në procesin e kujdesit shëndetësor / kujdesin shëndetësor;
- Dokumenton ndërhyrjet dhe ecurinë drejtë rezultateve të pritura;
- Zbaton të rejat shkencore në praktik e mbështetura në evidencë;
- Merr pjesë në edukimin e studentëve dhe në trajnimin profesional të personelit infermieror;
- Kujdesi për planifikim familjar;
- Kujdesi gjatës shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes;
- Kujdesi për të porsalindurit dhe të ushqyerit me gji.

6.6 Infermier i diplomuar / Master Profesional në infermieri

- Janë bartës të edukimit të vazhdueshëm profesional;
- Hartojnë planprograme për EVP;
- Mbikëqyrin praktikën profesionale të studentëve të nivelit Bsc;
- Merren me aktivitete shkencore në lëmin e infermierisë;
- Inicon programe dhe aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore me theks të veçantë infermiore;
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit infermior;
- Harton performancën e punës së stafit infermior.

6.7 Specialist të infermierisë

Është infermier/e i/e përgatitur përtej nivelit të një infermieri/e me Bsc dhe i/e autorizuar për tu praktikuar si specialist me ekspertizë të avancuar në një degë të fushës së infermierisë. Praktika e specialistit përfshin rolin klinik, mësimdhënien, administrimin, hulumtimin dhe konsulencën.

Neni 7

Për profesionistët shëndetësor nga pika 6.3 dhe 6.4 të nenit 6 me qëllim të ruajtjes së thirrjes profesionale që tani ushtrojnë, në rastin e harmonizimit me thirrjet dhe kompetencat e bashkimit evropian ministria e shëndetësisë dhe ministria e arsimit në bashkëpunim me OIK do të hartojnë module shtesë duke marr për bazë përvojën e punës në ofrimin e shërbimeve infermiore, me qëllim të barasvlerësimit me thirrjen Bsc.

Kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni do të përcaktohen me akt të veçantë.

ARSIMIMI

Neni 8

STANDARDI I ARSIMIT TË INFERMIERËVE

Edukimi themelor i një infermieri/e arrihet pas përfundimit me sukses të arsimit për atë profesion, në përputhje me plan programet e akredituara nga ministria përkatëse dhe legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës.

Me rastin e akreditimit të programeve duhet të ketë bashkëpunim institucional në mes të ministrisë së shëndetësisë, ministrisë së arsimit dhe OIK-ut për të siguruar se profili i akredituar infermieror është në pajtim me profilet shëndetësorë të përcaktuara me ligj dhe me nevojat e sistemit shëndetësor.

Neni 9

Infermierët kanë të drejtën dhe detyrimin e zhvillimit profesional nëpërmjet përsëritjes së vazhdueshme të njohurive të fituara dhe adoptimit të njohurive dhe aftësive të reja, në përputhje me arritjet dhe njohuritë më të fundit në fushën e infermierisë.

Të gjithë infermierët e licencuar janë të obliguar që të ndjekin edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të koherencës me të arriturat dhe të rejat profesionale në lëminë e infermierisë.

Programet dhe modulet e EVP duhet të jenë në përputhje me aktet e OIK dhe të akredituara.

Nevoja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e programit të trajnimit të mëtejshëm të infermierëve përcaktohet me akt të veçantë të OIK-ut.

Neni 10

Kandidatet të cilët pas diplomimit në periudhën 5 vjeçare nuk kanë ushtruar profesionit e përsërisin praktikën themelore me qëllim të rifreskimit të njohurive teorike dhe praktike.

Kandidatet të cilët kanë dështuar në arritjen e pikëve kredituese të EVP obligohen provimit të ri licencimit sipas moduleve të përcaktuara nga OIK.

Neni 11

Infermieret të cilët kanë një përvojë të caktuar pune në profilet jashtë profilit të licencuar kanë të drejt të licencohen në profile specifike pas dëshmisë se kanë ndjekur module shtesë të atij moduli dhe janë certifikuar në fushën përkatëse në pajtim me kriteret e përcaktuara nga OIK.

Neni 12

Institucionet janë të detyruara të mundësojnë, të sigurojnë dhe të ofrojnë edukimin e vazhdueshëm profesional duke ofruar programe specifike dhe lehtësira për vijimin e programeve të akredituara nga OIK.

KUSHTET PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË INFERMIERËVE

Neni 13

1. Të gjitha profilet infermiere nga neni 6 pika 6.2 deri te pika 6.4 kanë obligim të ndjekin praktikën profesionale pas diplomimit në kohëzgjatje prej 3 muaj.
2. Profilet infermiere të nivelit Bachelor dhe të niveleve tjera që paraprakisht nuk kanë përfunduar shkollimin e mesëm të profilit mjekësor do ti nënshtrohen stazhit themelor në periudhë 6 mujore.
3. Përjashtim nga paragrafi 1 këtij neni bëjnë profesionistët shëndetësor nga pika 6.4 dhe 6.5 të cilët kanë mbi 3 vite përvojë pune në fushën e infermierisë institucionet shëndetësore të licencuara nga ministria e shëndetësisë.

Neni 14

Përmbajtjen e plan programeve sipas profileve specifike infermiere e përcakton OIK e cila mbikëqyr cilësinë dhe mbarëvajtje e procesit të praktikës.

Kandidatët me fillimin e praktikës pajisen me librezën e stazhit të praktikës të cilën kanë për obligim ta mbushin dhe ta vërtetojnë nga institucionet ku ushtrohet praktika në pajtim me planin dhe programin e përcaktuar nga OIK.

Pas përfundimit të praktikës profesionale të gjithë kandidatët i nënshtrohen testit të aftësive të fituara gjatë praktikës profesionale.

OIK përcakton plan programin e provimit verifikues të aftësive të fituara për të gjitha profilet infermiere dhe profileve tjera analoge.

Pas përfundimit me sukses të provimit verifikues kandidati pajiset me certifikatë përkatëse për provim shtetëror të licencës.

Neni 15

Të drejtën e ushtrimit të profesionit kanë infermierët të cilët plotësojnë kriteret arsimore dhe kanë përfunduar aktivitetet sipas nenit 13 dhe 14 të këtij ligji.

Ri licencimi dhe revokimi i licencave bëhet në pajtim me aktet e OIK-ut.

PËRFAQËSIMI – MBROJTJA E INTERESAVE PROFESIONALE

Neni 16

Prezantimi, përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave profesionale infermiere sigurohet në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësorë, me pjesëmarrje në strukturat menaxhuese të institucioneve shëndetësore dhe në mekanizmat menaxhues, administrues dhe vendimmarrës në kuadër të ministrisë së shëndetësisë dhe institucioneve tjera.

Institucionet publike shëndetësore dhe institucionet tjera ku ushtrohet veprimtari infermierore në strukturën e vetë menaxhuese krijojnë strukturën institucionale me kompetenca të barazvlefshme me profilet tjera.

SHKELJET ETIKE DHE PROFESIONALE

Neni 17

Gjatë ushtrimit të profesionit infermierët kanë për obligim respektimin e ligjit akteve normative dhe kodit të etikës profesionale.

Detyrimet etike përcaktohen me kodin e etikës infermierore nga ana e OIK.

Shkelësit e kodit të etikës do të ndëshkohen dhe do të iu shqiptohet masë ndëshkuese në pajtim me kodin e etikës profesionale.

DISPOZITAT KALIMTARE

Pas miratimit të këtij ligji në afat prej 6 muaj të gjitha institucionet shëndetësore dhe institucionet tjera ku ofrohen shërbime infermierore kanë për obligim të harmonizojnë të gjitha aktet normative me këtë ligj.

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i republikës së Kosovës dhe shpalljen në gazetën zyrtare.